FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

ASP AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE

POLICY BRIEF

RIINTEGRIMI SOCIAL I PERSONAVE QË KANË KRYER VEPËR PENALE:

Një mekanizëm referimi kombëtar për kategorinë "të dënuar në shërbim prove" dhe "ish të dënuar"

Evis Fico

2016

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit drejtuar alumnëve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike me titull "Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri".
Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përkasin tërësisht autorëve.

RIINTEGRIMI SOCIAL I PERSONAVE QË KANË KRYER VEPËR PENALE:

Një mekanizëm referimi kombëtar për kategorinë "të dënuar në shërbim prove" dhe "ish të dënuar"

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përfshirja sociale e personave që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo e atyre që vuajnë një dënim alternativ, përmes masave e politikave aktive të formimit profesional dhe punësimit, përbën një hap kryesor drejt një reforme që ndikon në drejtësinë restauruese. Të dënuarit me dënime alternative duhet të përballen me kufizime të lirisë duke qenë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për një afat 18 muaj deri në 5 vjet. Në vuajtjen e dënimit ka të rinj, kryefamiljarë, persona të braktisur, jetimë, apo viktima të trafikimit. Shërbimi i Provës bashkëpunon me pushtetin lokal për të mbështetur të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata. Por, institucionet publike si në nivel qëndror ashtu dhe lokal nuk disponojnë të dhëna të plota për punësimin apo formimin profesional për këtë kategori; edhe në rastet kur i disponojnë, numri i tyre është i pakonsiderueshëm. Gjithashtu, nuk ka një model të mirëfilltë operimi – pavarësisht se është parashikuar që të ekzistojë bashkëpunimi me punonjësit socialë të pushtetit lokal – në fushat e punësimit, strehimit, shkëmbimit të informacionit, etj.

Ndaj, ky dokument politikash ka dy qëllime kryesore: analizimin e problematikave kryesore që lidhen me trajtimin aktual të kategorive në fjalë në shërbim prove, si dhe analizimin e situatës aktuale në një prej bashkive në vend që mund të konsiderohet si rast suksesi në riintegrimin e këtyre kategorive, siç është Bashkia Korçë, gjetjen e pikave pozitive dhe problematikave të hasura tek kjo bashki gjatë punës me këtët kategori, duke nxjerrë edhe rekomandime për pushtetin lokal dhe institucionet qëndrore. Këto rekomandime kanë si objektiv të tyre: (1) **referimin e një modeli apo praktike të mirë** të procesit tek bashki të tjera; (2) në terma afatgjatë synon hartimin dhe advokimin e një propozimi në nivel politikash për **ngritjen e një mekanizmi kombëtar referimi** me fokus rehabilitimin e qëndrueshëm dhe punësimin në nivel lokal/komunitar të grupit të sipërpërmendur; si dhe (3) **ngritjen e një databaze** (*regjistri kombëtar të dhënash për kategorinë në fjalë*) unike që do t'i vijë në ndihmë institucioneve që merren me trajtimin e kësaj kategorie.

SITUATA E ISH TË DËNUARVE DHE TË DËNUARVE NË SHËRBIM PROVE

Në qendër të politikave të punësimit, si politika gjithëpërfshirëse dhe shumëplanëshe, vazhdimisht qeveritë apo pushteti vendor kanë vendosur në fokus kategori që sipas ligjit të nxitjes së punësimit[1] quhen "të veçanta" apo "të marxhinalizuara" në shoqëri. Vazhdimisht i është vënë theksi grupit të të rinjve të sapodiplomuar, grave apo personave në vështirësi ekonomike, personave me aftësi të kufizuar, etj. Gjatë një periudhe 8-vjeçare, dhe jo vetëm, janë miratuar dhe zbatohen politika apo incentiva nxitëse të punësimit për këto kategori[2], por ende nuk janë bërë hapat e duhur drejt një grupi të veçantë siç është *grupi i personave të cilët kanë vuajtur dënimin me burgim apo që janë në shërbim prove*. Deri më sot, kjo mbështetje është rregulluar në nivel memorandumi mirëkuptimi/marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve ekzekutive.

Realisht, çfarë ndodh me ish të dënuarit dhe personat në shërbim prove? A punësohen ata, apo vetëm kryhet një detyrim formal burokratik i procedurës së zbatimit të vendimit dhe më pas ata mbeten pa punë?

Kategoria më e madhe e tyre janë *të rinj*, apo edhe *të mitur* (deri në 18 vjeç) që bëhen pjesë e krimit, shumë të tjerë janë *jetimë, kryefamiljarë*, etj[3]. Pas komunikimit që patëm me Shërbimin e Provës, si një organ i krijuar rishtazi në vitin 2009[4], *trajtimi për këtë kategori për punësimin apo mbështetjen psiko-sociale është në nivele jo të kënaqshme*. Ndërmjetësimi dhe mbajtja në punë pas përfundimit të mbikëqyrjes bëhet i vështirë. Paragjykimi në lidhje me punësimin e tyre është prezent. Ndërkohë, kjo është kategoria më *sensitive* që i rikthehet krimit nëse nuk mbështetet me trajtim social dhe punësim. Nëse arsyet/rrethanat që kanë çuar një ish të dënuar në shkeljen e ligjit vazhdojnë të jenë prezente dhe të pa adresuara, në momentin që i dënuari përfundon dënimin, mundësia e përsëritjes së shkeljes është e madhe. Një i varfër që ka kryer vjedhje do t'i rikthehet këtij veprimi nëse nuk ndihmohet të arsimohet apo formohet profesionalisht për t'u integruar në tregun e punës.

Adresimi i këtij problemi kërkon një angazhim të veçantë të qeverisjes vendore në trajtimin e kësaj kategorie. Pushteti vendor mund dhe duhet t'i integrojë në punë komunitare, apo çdo iniciativë lokale, duke bashkëpunuar me 22 zyrat[5] e Shërbimit të Provës në çdo lokalitet. Një politikë e tillë vendore, duhet të paraprihet nga një hulumtim, të dhëna të sakta, ndërhyrje dhe advokaci me qëllim përfshirjen sociale dhe riintegrimin e qëndrueshëm në komunitet të kategorisë së ish të dënuarve dhe të dënuarve në shërbim prove.

Për pasojë, ky dokument politikash ka si qëllim analizimin e situatës aktuale, gjetjen e pikave pozitive dhe problematikave të hasura gjatë procesit të monitorimit të punësimit të të dënuarve në shërbim prove, duke nxjerrë rekomandime për pushtetin lokal dhe institucionet qëndrore. Ndër rekomandimet më të rëndësishmet janë: ngritja e një mekanizmi kombëtar referimi si dhe ngritja e një regjistri kombëtar të dhënash për kategorinë në fjalë. Nisur nga informacioni dhe të dhënat e disponuara nga Shërbimi i Provës, ky studim është përqëndruar në punën e Bashkisë Korçë, duke e marrë atë si rast studimor, si një prej bashkive që ndjek punësimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të vendimit gjyqësor "Punë me interes publik". Ky rast suksesi është analizuar me qëllim adoptimin edhe në bashkitë e tjera, si për shembull në Bashkinë Tiranë. Kjo bashki ka të gjithë strukturën e përshtatshme të organizimit dhe funksionimit për të ndjekur një proces të mirëfilltë riintegrimi për kategorinë në fjalë, duke patur parasysh faktin e ndarjes së mirëpërcaktuar të drejtorive.

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

Të dënuarit me dënime alternative duhet të përballen me kufizime të lirisë duke qenë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës *për një afat 18 muaj deri në 5 vjet*, të kryejnë punë në interes publik, apo të përmbushin detyrime të tjera të vendosura nga gjykata. Në vuajtjen e dënimit *ka të rinj, kryefamiljarë, persona të braktisur, jetimë, apo viktima të trafikimit*[6].

Mbizotëron në masë te madhe aplikimi nga gjykata i nenit 59 të Kodit Penal *"pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë"*, duke bërë të mundur mosdërgimin në burg për vuajtjen e dënimit të autorëve të veprave penale, por kalimin e tyre nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e provës.

> Evident është edhe aplikimi nga gjykata i nenit 63 të Kodit Penal (KP) në dhënien e dënimit alternativ "Punë me interes publik". Numri i të dënuarve me këtë dënim në të gjithë vendin është i lartë dhe shtohet nga viti në vit.[7] (75% e të dënuarve me dënime alternative shlyejnë dënimin alternativ "Punë me interes publik").

Në rritjen e numrit të aplikimit të këtij dënimi të dhënë nga gjykata ka ndikuar edhe nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me 244 njësi të qeverisjes vendore (qarqe, bashki, komuna) në mbarë vendin[8].

Misioni dhe funksionimi i Shërbimit të Provës

Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me Ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë miratoi kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit[9]. *Ky Shërbim bashkëpunon me pushtetin lokal për të mbështetur të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata*. Për realizimin e bashkëpunimit, Shërbimi i Provës ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi, ku thelbi i tyre është sigurimi i vendit të punës për personat me vendbanim në komunitetin e tyre, për të cilët gjykata ka dhënë si masë alternative punën me interes publik. Bashkëpunimi është parashikuar edhe për rastet e të dënuarve me dënime të tjera alternative, për të cilat pushteti vendor është drejtpërdrejt i interesuar me qëllim garantimin e sigurisë publike të komunitetit dhe riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar që është anëtar i atij komuniteti.[10]

Punonjësit socialë të këtij institucioni janë parashikuar të punojnë me komunitetin dhe koordinojnë një sistem mbështetës për të dënuarin pas lirimit nga burgu, si: gjetjen e një pune, sigurimin e ushqimit, strehimit, veshjes, transportit, vendosja e lidhjeve me të tjerët, etj.[11] Megjithatë, kjo ka mbetur në letër për shkak të mungesës së mekanizmit koordinues të një zinxhiri pune.

ANALIZA E PROBLEMIT

Institucionet publike si në nivel qëndror ashtu dhe në nivel lokal nuk disponojnë të dhëna për punësimin apo formimin profesional për këtë kategori; edhe në rastet kur disponojnë numri i tyre është i pakonsiderueshëm[12]. Gjithashtu, nuk ka një model të mirëfilltë - pavarësisht se është parashikuar që të ekzistojë bashkëpunimi me punonjësit socialë të pushtetit lokal – në fushat e punësimit, strehimit, shkëmbimit të informacionit, etj.[13]

Problematikë e hasur është ajo e të dënuarve me punë me interes publik të cilët e kanë të përcaktuar në vendim gjykate qendrën në të cilën do të zhvillojnë dënimin e tyre, por pas verifikimeve të kryera nga zyra e Shërbimit të Provës, këto qendra rezultojnë të mbyllura.[14]

Për më tepër, paragjykimi i mbajtjes në punë pas periudhës së mbikëqyrjes së kësaj kategorie mbetet i lartë. Për periudhën 6-vjeçare (2009-2015) të funksionimit të Shërbimit të Provës figurojnë të mbikëqyrur afro njëzet mijë (20.000) të dënuar me dënime alternative, ku rreth dymbëdhjetë mijë (12.000)[15] kanë përfunduar procesin e mbikëqyrjes së dënimit alternativ. *Këta persona potencialisht të aftë për punë praktikisht nuk paraqiten pranë zyrave të punës apo bashkive.* Për të gjithë këta persona Shërbimi i Provës ka hasur vështirësi për ndërmjetësimin me institucionet shtetërore në nivel vendor si për punësim, formim apo mbështetje sociale[16]. Për pasojë, *riintegrimi i tyre është tejet i vështirë dhe rezultati jo i kënaqshëm.*

Puna e Shërbimit të Provës është ndërlikuar nga dy faktorë kryesorë[17]: 1) Shërbimi është përpjekur të ndikojë dhe ndryshojë vendimmarrjen e organizmave të tjera (të cilave iu mbetej përgjegjësia përfundimtare për veprimet e tyre, sikundër është dhe rasti i Bashkisë Korçë punës të së cilës i jemi referuar); dhe 2) Shërbimit i duhet të punojë me individë në rrethana sociale komplekse dhe të ndryshueshme të cilat nuk mund të parashikohen apo kontrollohen lehtë.

ANALIZA E NJË RASTI SUKSESI

Sikundër u theksua me lart, mbikëqyrja e përmbushjes së masave të vendosura nga gjykata bëhet nga Shërbimi i Provës dhe në rastet e ma-

save specifike në bashkëpunim me shërbime të jashtme (organizata, agjenci, institucione, etj) të cilat janë të specializuara në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Cili është modeli që ndiqet për punësimin, aftësimin e tyre profesional dhe riintegrimin e tyre sa më të qëndrueshëm në shoqëri me qëllim mbështetjen dhe zvogëlimin e hapësirës së ripërtëritjes së krimit?

Sipas informacionit të Shërbimit të Provës, një nga bashkitë që ndjekin këtë proces dhe që ka rezultuar i suksesshme është edhe Bashkia Korçë, e cila prej vitit 2010 zbaton me korrektësi marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre. Bashkia ka të gjithë potencialet dhe strukturat e nevojshme për zhvillimin e punës në interes publik nga ana e të dënuarve. Ndaj puna e Bashkisë Korçë është zgjedhur në këtë analizë për ta paraqitur si një rast suksesi në lidhje me të dënuarit me punë me interes publik.

Modeli i bashkëpunimit me Bashkinë Korçë

Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 333 të dënuar me dënime alternative.

Bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me këtë bashki ka filluar në nëntor të vitit 2010 me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit midis dy institucioneve[18]. Mënyra se si realizohet koordinimi me Bashkinë Korçë është që, fillimisht, bëhet referim i rasteve nga Shërbimi i Provës tek bashkia. Bashkia më pas bën referimin tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike e cila përcakton vendin e punës për kryerjen e punës me interes publik nga i dënuari, që mbikëqyret nga një person përgjegjës. Në përfundim hartohet tabela e monitorimit për kryerjen apo jo të punës duke u shoqëruar me raportin përkatës.

Tabela: (Prej vitit 2010 deri në gusht 2016 ka një numër prej 50 të dënuarish që kanë përfunduar këtë proces, prej të cilëve vetëm një nuk ka kryer punën e paracaktuar).

Në bashki është caktuar një person përgjegjës për bashkëpunimin me Shërbimin e Provës, i cili merr pjesë në aktivitete lidhur me këtë kategori, por që nuk e ka të mirëpërcaktuar këtë detyrë si rezultat i lidhjes së shkurtër mes Shërbimit të Provës dhe ndërmarrjes së shërbimeve publike[19]. Gjithsesi, duhet theksuar se në tërësinë e të dhënave të marra nga aktorët e përfshirë në këtë proces dhe pas vlerësimit të kryqëzuar të tyre, rezultati i bashkëpunimit është mjaft pozitiv dhe funksionin më së miri. Veçanërisht në kuadër të kësaj marrëveshje bashkia shtrin bashkëpunimin për këtë kategori me:

Bashkëpunimi i bashkisë me OJF

Me qendrën Meridia për minorenët e dënuar për të nxitur formimin profesional duke ofruar kurse të ndryshme profesionale, si dhe veprimtari me karakter edukativ, sportiv, kulturor dhe artistik.

Bashkëpunimi me zyrat e punës

Sipas të dhënave të deklaruara nga zyra e punës janë punësuar 2 ish të dënuar. Në vitin 2014 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit të Provës dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit për përfshirjen e tyre në programet e nxitjes së punësimit dhe përfshirjen në kurset e formimit profesional.

Bashkëpunimi me Qendrat e Formimit Profesional (QFP)

Në QFP Korçë janë trajnuar 11 persona prej të cilëve 5 të mitur si rezultat i marrëveshjes midis Qendrës dhe Shërbimit të Provës. Drejtoria Korçë rezulton që ka kryer me sukses këtë formim.

Janë organizuar kurse specifike, trajnime, leksione të hapura apo seminare në lidhje me tematika që kanë interes studimor ose praktik, duke respektuar së pari vullnetin e të dënuarve me dënime alternative.

Janë organizuar programe psiko-sociale (në varësi të nevojave konkrete kriminogjene të të dënuarve), të organizuara në grupe apo individualisht nëpërmjet kombinimit të këshillimit psiko-social me atë social dhe ligjor.

MODEL PËR BASHKITË E TJERA

Rasti i riintegrimit të ish të dënuarve dhe të dënuarve në shërbim prove në Bashkinë Korçë, pavarësisht vështirësive të hasura, është një model suksesi për t'u ndjekur edhe nga bashkitë e tjera ku shtrihet Shërbimi i Provës (21 Bashki të tjera).

Veçanërisht, do të sugjeronim ndjekjen e këtij modeli në Bashkinë e Tiranës, jo vetëm për shkak të nivelit të lartë të popullsisë së përqëndruar në kryeqytet, por nisur dhe nga fakti që kjo bashki ka në organikën e saj stafin e përshtatshëm për punësimin (Drejtoria e Punësimit) bashkë me Drejtorinë e Punëve Publike dhe Drejtorinë e Kujdesit Social, të cilat mund të ndjekin këtë veprimtari përmes krijimit të një **mekanizmi referimi ku të jenë të përcaktuara të gjithë pikat kyçe të referimit rast pas rasti të personave në mbikëqyrje**. Marrë shkas dhe nga takimi i fundit në Bashkinë Korçë, zhvilluar me datë 11 korrik 2016, në të cilin ishin prezent përfaqësues të nivelit të lartë dhe teknik të Drejtorisë së Burgjeve, Shërbimit të Provës, Drejtorisë së Kujdesit Social, Zyrës së Punës, Qendrës së Formimit Profesional etj, plani pilot i përcaktimit të këtij mekanizmi se "*kush duhet të bëjë çfarë*" shihet me prioritet.[20]

REKOMANDIME

Nga sa më sipër, ky studim vjen me disa rekomandime drejtuar kryesisht pushtetit lokal dhe atij qendror dhe në veçanti organizatave që kanë në fokusin e tyre formimin profesional, përkrahjen sociale dhe punësimin e kategorisë në fjalë.

I. Pushtetit Lokal

I.A Bashkisë Korçë

I.A.1. Përfshirje më të gjerë të strukturave të Bashkisë Korçë të cilat merren me kujdesin social dhe përfshirjen sociale, dhe jo vetëm lënia në dorë e zbatimit dhe koordinimit të punës tek Drejtoria e Ndërmarrjes së Punëve Publike. Kështu, duhen angazhuar strukturat e bashkisë që merren me përfshirjen dhe trajtimin social *përmes ndërtimit të një mekanizmi referimi*.

Duhet theksuar se aktualisht ky mekanizëm përbën një ngërç në koordinimin e punës në Bashkinë Korçë për të bërë plane individuale konkrete dhe për të ndjekur procesin. Në bashki është caktuar një person përgjegjës për bashkëpunimin me Shërbimin e Provës, i cili merr pjesë në aktivitete lidhur me këtë kategori por që nuk e ka të mirëpërcaktuar këtë detyrë si rezultat i lidhjes direkte mes Shërbimit të Provës dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Kërkohet një ndarje më e mirëpërcaktuar e detyrave *de jure* dhe *de facto* për të ndjekur këtë proces, i cili është i një rëndësie të veçantë.

I.A.2. Bashkia duhet të ketë *një staf të përshtatshëm i cili në çdo kohë të raportojë për situatën* dhe përfshirjen sociale të të dënuarve në shërbim prove që trajtohen nga ajo.

I.A.3. *Hartimi i një plani ndihmës të përbashkët veprimi midis bashkisë dhe zyrës së Shërbimit të Provës* do të sillte rezultate të kënaqshme në procesin e riintegrimit për të dënuarit që kanë vështirësi të tilla.

I. B. Bashkive të tjera

I.B.1. Rekomandojmë implementimin e modelit të bashkëpunimit edhe tek bashkitë e tjera, si për shembull Bashkia Tiranë, që ka popullsi të madhe dhe organikë të përshtatshme për funskionimin dhe mbarëvajtjen e te gjithë procesit të asistimit të kësaj kategorie. Gjithashtu, kjo bashki duke qënë se ka një njësi projektesh për grupet vulnerabël mund të advokojë në Këshillin Bashkiak për një fond për mbështetjen në formim profesional të të miturve që janë në Shërbim Prove.

I.B.2. Bashkëpunimi më i gjerë i tyre me OJF që ndihmojnë familjet në nevojë.

I.B.3. Bashkëpunimin me OJF fokusi i të cilave është trajtimi i individëve përdorues të lëndëve narkotike, për trajtimin e të dënuarve, veçanërisht të rinjve.

I.B.4. Në komponentët e përfshirjes sociale dhe integrimit nuk është parashikuar si një kategori e veçantë ish të dënuarit apo ata të dënuar me shërbime alternative[21], për t'u trajtuar me shërbime individuale dhe të përshkallëzuara punësimi. Duhet theksuar se ky është një grup që zë një përqindje në forcën aktive të tregut të punës, ndërkohë që hyn në zonën gri të informalitetit si nga ana e punësimit ashtu edhe të dhënave statistikore, duke mos pasur një hartë të saktë[22] të peshës që zë kjo kategori në treg. Ndaj, *shihet me përparësi vlerësimi me prioritet i kësaj kategorie në menaxhimin e punës*. Ky rekomandim vlen edhe për pushtetin qëndror dhe zyrat e punës.

I.B.5. Gjithashtu, nevojitet *një punë më e mirë për sa i përket shërbimit social dhe trajtimit të të miturve nga ana e psikologëve bashkiakë.*

II. Shërbimit të Provës

II.1. *Bashkëpunim më i ngushtë me pushtetin lokal* për sa i përket zbatimit të punës me interes publik, sipas nenit 63 KP.

II.2. *Bashkëpunim ndërsektorial me drejtoritë arsimore dhe psikologët e shkollave për të hartuar plane konkrete* për trajtimin e të miturve dhe zhvillimin psiko-social të tyre.

II.3. Propozim dhe realizim i një *plani pilot* për mënyrën e asistimit të personave që kanë kryer dënimin apo kryejnë një dënim alternativ përmes planeve individuale të veprimit për çdo individ duke përfshirë çdo shërbim. Këtu me rëndësi do të ishte bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme, Policinë dhe OJF që shërbejnë në fushën e mbështetjes sociale.

II.4. Propozim për *ngritjen e një databaze unike* (regjistër kombëtar të dhënash për kategorinë në fjalë) që do t'u vijë në ndihmë institucioneve që merren me trajtimin e kësaj kategorie.

III. Pushtetit qëndror

III.1. Hartimi i politikave të nxitjes së punësimit të kësaj kategorie, për formimin profesional dhe riaftësimin për punë nëpërmjet hartimit të programeve subvencionuese të punësimit për kategoritë që vuajnë dënim penal apo dënime të tjera alternative. Deri tani politikat e punësimit janë fokusuar në nxitjen e punësimit të grupeve si: PAK, jetimë, nëna me shumë fëmijë, grupmoshat 15-29 vjeç, grupet në vështirësi, etj. Kjo kategori nuk është trajtuar.

Sugjerohet hartimi i një mase aktive apo një politike për përfshirjen sociale të të dënuarve si: masa në komunitet, shërbime komunitare, ndërmjetësim, plane individuale, veçanërisht për personat të cilët nuk kanë kapacitetin e duhur për të gjetur një vend pune, strehim, nuk kanë mundësi të ndjekin një kurs edukativ apo formimi profesional, etj.

III.2. Politikat kanë nevojë për akte që të parashikojnë integrimin, formimin, punësimin dhe trajtimin social të kësaj kategorie. Shihet si domosdoshmëri përfshirja e këtij grupi për punësim dhe formim veçanërisht pas kryerjes së dënimit *në planin e masave të Strategjisë Kombëtare për Arsim dhe Aftësi.*

III.3. Shtimi i kurseve të reja si për të miturit ashtu dhe adultët në shërbim prove apo atyre që kanë përfunduar dënimin me burgim[23]. Këto kurse të bëhen nga Qendrat Publike apo Private të Formimit të asistuara edhe nga OJF të ndryshme, që veprojnë në këto fusha, si Save the Children, Swiss Contact, UNDP, etj.

Burime

1 Ligji i nxitjes së punësimit nr. 7995 dt. 20.09.1995, i ndryshuar, neni 2, pika 20.

2 Shih 7 programet e nxitjes së punësimit për kategori të ndryshme si: VKM nr. 27 datë 11/01/2012 "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra"; VKM nr. 64 datë 27/01/2016 "Programi I nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit"; VKM nr. 199 datë 11/01/2012 "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj", i ndryshuar; VKM nr. 47 datë 16/01/2008 "Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë", i ndryshuar; VKM nr. 48 datë 16/01/2008 "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve në vështirësi", i ndryshuar; VKM nr. 873 datë 27/12/2006 "Programi i praktikave profesionale për të sapo diplomuarit", i ndryshuar; VKM nr. 248 30.04.2014 "Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara".

3 Sipas të dhënave të Shërbimit të Provës, janë trajtuar 14581 të mitur nga 20 mijë persona me dënime alternative. Shih Buletinin Nr. 4, 2014 i Shërbimit të Provës, faqja 29, mbështetur nga OSBE.

4 Shërbimi i provës është organi shtetëror që paraqet informacion para autoriteteve gjyqësore, mbikëqyr ekzekutimin e dënimit alternativ dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Shih faqja 97 e Manualit për aplikimin e alternativave me burgim. OSCE 2010.

5 Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë nr. 6224/1 dt.07/09/2014 "Për përcaktimin e vendodhjes dhe kompetencave tokësore të zyrave vendoret të Shërbimit të Provës".

6 Shih Buletini 2014, Shërbimi i Provës, fq. 10-12. "Dënimet alternative janë gjithashtu një mënyrë e mirë për të bërë trajtimin e diferencuar të të dënuarve sipas grupeve të veçanta në të cilat bëjnë pjesë, si p.sh.: të miturit, gratë, të moshuarit, të sëmuret mendore, personat me varësi ndaj substancave narkotike, personat, të cilët kanë probleme shëndetësore që kërkojnë trajtim të specializuar, të dënuar që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijë të mitur, të cilët nuk mund ta kenë përndryshe kujdesin prindëror etj...".

7 Shih Raporti vjetor 2013, 2014 i Shërbimit të Provës, seksioni VI, fq. 19, "Marrëdhëniet me institucionet e tjera".

8 Ibid, Raporti vjetor 2013, 2014. Këto marrëveshje janë të vlefshme edhe pas reformës administrativo – territoriale, gjithsesi Shërbimi i Provës po punon edhe me njësitë e reja të qeverisjes vendore për nënshkrimin e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit.

9 VKM nr. 302 dt. 25.03.2009 Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative.

10 Shih faqja 127 e Manualit për aplikimin e alternativave me burgim. OSCE 2010."rritja e nivelit të sigurisë publike duke informuar dhe këshilluar viktimat e krimit, duke nxitur përdorimin e masave alternative ndaj dënimit me burgim, duke parandaluar krimin, duke zvogëluar mundësinë për recidivizëm dhe nëpërmjet riintegrimit social të atyre personave që kanë kryer një vepër penale"si dhe Buletinin e Shërbimit të Provës, 2014, fq. 24- cont.

11 Buletini i Shërbimit të Provës, 2014, fq. 24.

12 Deklaratë e punonjëses së zyrës së punës Korçë në tryezën e rrumbullakët të datës 11 Korrik 2016 duke deklaruar që është e vështirë punësimi i tyre.

13 VKM nr. 302, datë 25.03.2009

14 Raporti i punës për periudhën 2009-2015.

15 Raporti i punës për periudhën 2009-2015, fq. 2-5, kapitulli I, pika 2, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

16 Informacioni i z. Ilir Qafa, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, datë 23.03.2015.

17 Shih Manualin për aplikimin e alternativave me burgim. OSCE 2010, fq. 41.

18 Marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe OJF të ndryshme, 4 memorandume te nënshkruara, dhe 27 Memorandum bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe bashkive e komunave te vendit. Të gjitha sa më sipër janë pjesë përbërëse e bazës ligjore të zbatueshme nga Shërbimi i Provës. Ato synojnë jo vetëm rritjen e transparencës dhe të mirëfunksionimit të Shërbimit të Provës, por edhe standardizimit të praktikave të këtij Shërbim dhe krijimin e traditës.

19 Intervista me znj. Elizeta Vando, Korrik 2016.

20 Minutat e takimit të tryzës së rrumbullakët me qëllim bashkërendimin e punës për të ndihmuar dhe lehtësuar qëndrimin e të miturve që vuajnë paraburgim, iniciuar nga Shërbimi i Provës, Bashkia Korçë dhe Drejtoria e Burgjeve në qendër, 11 Korrik 2016.

21 Ndërkaq përmenden si kategori me rrezik të lartë përjashtimi social, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë e rrezikuar, grupet e veçanta të femrave dhe pakicat rome dhe egjiptiane, grupi i ish-të dënuarve apo në shërbim prove nuk përmenden si kategori në rrezik përjashtimi social.

22 Në zbatim të nenit 26, pika 3, të VKM nr. 302, datë 25.03.2009, parashikohet që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit te Provës krijon regjistrin elektronik, në të cilat regjistrohen të dhënat e zyrave vendore. Ky regjistër nuk është krijuar ende. Krijimi i tij është një ndër objektivat më të afërta për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës. (shih Raporti Vjetor i Shërbimit të Provës 2014, fq. 5).

http://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrcs/pblctns/scl-rntgrtn/index-en.aspx.

23 Deri më tani ky veprim bëhet për të dënuarit me burgim në bazë të marrëveshjes së lidhur midis Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta(sot MMSR)dhe Ministrisë së Drejtësisë nr. 1366 & 5587 datë 07.07.2009. Kurset e kërkuara dhe të ndjekura prej tyre janë Gjuhë e huaj, përdorim kompjuteri, hidraulik, etj.